


**DR. PAVEL HRADEÇNI**

Më 17 qershor 2006 u nda nga jeta në moshën 67 vjeçare pas një sëmundje të rëndë, studiuesi bashkëkohës më i njohur çek i historisë së shqiptarëve, Dr. Pavël Hradečni.

Shkencëtari i shquar lindi në Berno të Çekosllovakisë më 30.10.1938. Pas arsimimit fillestar e të mesëm ai në vitet 1956-1959, 1960-1961 vijoi studimet në Fakultetin Filozofik të Universitetit Masarik në Bernë me një zhvendosje në Universitetin e Tiranës, për t'u specializuar për albanologji në vitin 1959-1960.

Gjatë kësaj periudhe gati dyvjeçare në Shqipëri ai iu kushtua përfundimisht studimit të gjuhës dhe historisë së popullit shqiptar.

Qysh në vitin 1963, P. Hradečni ishte punonjës shkencor në Universitetin e Bërnës dhe konsiderohej specialist për Shqipërinë. Në vitin 1966, tashmë historian në Institutin e Historisë së Vendeve Socialiste të Europës, pati rastin të specializohej më tej në Beograd e Prishtinë për fushën e tij të studimit. Disa nga punimet që pasuan, të cilat i dhanë rast të konsiderohej historiani më kompetent në Çekosllovakia për historinë e shqiptarëve, ishin “Shqipëria midis dy luftërave botërore”, “Europa Qendrore e Juglindore në luftë a revolucion?”, “Shqipëria dhe Bullgaria midis dy luftërave”, “Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë”, “Marrëdhëniet shqiptaro-kineze” etj.

Ndonëse i dënuar më 1968 si simpatizues i “Pranverës së Paqes”, P. Hradečni nuk u ndal në punën e tij studimore dhe në 1989 mbrojti temën “Problematika e zhvillimit të politikës së jashtme dhe të brendshme të Shqipërisë në periudhën 1939-1978”, për gradën “Kandidat i shkencave historike”.

Gjatë periudhës së luftës në Kosovë në vitet 1998-1999, Hradečni doli hapur para opinionit çek dhe atij ndërkombëtar në mbrojtje të çështjes së drejtë të shqiptarëve atje, me artikuj, intervista, debate

televizive, biseda etj. Madje u angazhua sa mundi për të ndihmuar refugjatët kosovarë të strehuar në Republikën Çeke. Me interesimin personal të presidentit çek Havel u aktivizua në organizatën humanitare “Njeriu në fatkeqësi”, si edhe në mësimdhënien e gjuhës shqipe për trupat çeke, që u dërguan në Kosovë në kuadër të KFOR-it.

Prej shumë vitesh P.Hradeçni punonte për përgatitjen e një historie voluminoze të Shqipërisë për të cilën ndërmoi disa udhëtime hulumtuese në Shqipëri. E kam takuar atë në vitin 2003 dhe 2005 kur ndërmoi një udhëtim në Shqipëri dhe kreu kërkime në Arkivin Qendror Shtetëror dhe në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Me këtë rast ai ishte mik edhe në Institutin e Historisë, duke dëshmuar në disa biseda të ngrohta e shumë të përzemërta interesin për të rritur bashkëpunimin deri institucional në fushën e historiografisë shqiptare e çeke. Diçka edhe filloi menjëherë spontanisht me shkëmbim pikëpamjesh, literature e skicim projektsh.

Në bisedat e paharrueshme me të kemi folur për botime reciproke studimesh, për shkëmbim lektorësh e organizim takimesh në tryeza të rrumbullakëta për tema me interes të ndërsjellë, për botime të përbashkëta studimesh e dokumentesh në nivel institucional për probleme të historisë së Europës Juglindore, për shkëmbim literature shkencore e periodikësh, për pjesëmarrje reciproke në sesione shkencore, për shkëmbim informacioni për indikacione arkivore e bibliografike me interes të ndërsjellë, për të realizuar në shqip një histori të shkurtër të Çekisë etj.

Pak kohë pas udhëtimit të tij në Shqipëri P.Hradeçni u sëmur rëndë. I vinte keq që nuk do të mund të mbaronte punën e filluar për hartimin e Historisë së Shqipërisë. Në këtë merak u nda nga jeta duke u shkaktuar dhimbje të ndjerë jo vetëm të afërmeve dhe kolegëve të tij në Çeki, por edhe kujtudo këtu në Shqipëri që sado pak e njohu Pavlin e dashur, korrekt e shumë njerëzor. Historia e Shqipërisë sidoqoftë doli në dritë në 2008, me angazhimin e miqve e kolegëve të tij si Ladislav Hladky dhe familjarëve të tij, veçanërisht bashkëshortes, Maries.

I jemi mirënjohës P.Hradeçnit për këtë vepër, që i sjell kombit çek në gjuhën e vet historinë e Shqipërisë dhe ndihemi në borxh për të botuar së paku të përkthyer në shqip një histori të shkurtër të Çekisë, gjithashtu për të patur në shqip këtë histori tonën të shkruar shkencëtarit çek, mik i Shqipërisë dhe i shqiptarëve.

Njerëz si P.Hradeçni i bëjnë nder popullit që i lind. Ata janë farkëtuesit e lidhjeve dhe bashkëpunimit midis popujve. Historianët

---

shqiptarë shprehin nderimin dhe respektin e veçantë për kolegun çek P. Hradeçni dhe veprën e tij.

**Marenglen VERLI**  
**Hamit KABA**